

AKTI I THEMELIMIT

DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"ALPHA BASE COMPANY" Sh.p.k

KREU I

NENI 1

Sot ne daten 9.09.2019 (nente Shtator dy mijë e nentembedhjete), diten e Hene, ne themeluesit, kemi krijuar një shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin "**Alpha Base Company**" Sh.p.k.

Themeluesit e shoqerise jane:

1. **Marin Kutrolli**, i biri i Fatmir-it, lindur me 09.05.1996 ne Korce dhe banues ne Tirane, madhor dhe me aftesi te plete per te vepruar, me mjet identifikimi me numer BB4195016
2. **Olivia Ivanova Cholakova**, e bija e Ivan-it, lindur me 21.12.1996 ne Blagoevgrad dhe banuese ne Blagoevgrad, Bullgari, madhere dhe me aftesi te plete per te vepruar, me mjet identifikimi me numer 383699368

Selia e kesaj Shoqerie eshte ne Qendren e Biznesit Metropol, rruga Sami Frasherit ne Tirane ne ambientin me numer 7/467-N14, ZK.8380 vol.29 faqe 205.



STATUTI I SHOQERISE

Sot ne daten 9.09.2019 (nente Shtator dy mije e nentembedhjete), diten e Hene, se bashku me Ortaket e Shoqerise:

1. Marin Kutrolli, i biri i Fatmir-it, lindur me 09.05.1996 ne Korce dhe banues ne Tirane, madhor dhe me aftesi te plete per te vepruar.

2.Olivia Ivanova Cholakova, e bija e Ivan-it, lindur me 21.12.1996 ne Blagoevgrad dhe banuese ne Blagoevgrad, Bullgari, madhere dhe me aftesi te plete per te vepruar,

bazuar ne ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare",

Vendosem

Hartimin e Statutit te Shoqerise Tregetare me Pergjegjesi te Kufizuar "Alpha Base Company" sipas ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare".

Selia e kesaj Shoqerie eshte ne Qendren e Biznesit Metropol, rruga Sami Frasherit ne Tirane ne ambientin me numer 7/467-N14, ZK 8380 vol.29 faqe 205.

NENI 2


Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem, ne perputhje me ligjet ne fuqi:

"Alpha Base Company" Sh.p.k ofron sherbime marketing-u, ideimin dhe ekzekutimin e fushatave te marketingut per kompani dhe struktura te ndryshme (private, shteterore, OJQ etj.) konsulence biznesi, konsulence mbi Burimet Njerezo, trajnime te ndryshme per interesat e bizneseve apo organizatave jo-fitimprurese, kosulence ne sektorin Hoteleri- Turizem, konsulence ne menaxhimin e strukturave te lindhura direkt apo indirekt me Hotelerine dhe Turizmin, sherbime teknike ne Web, E-commerce, Krijimi dhe Tregetimi me te drejta te plota i Platformave te Ndryshme Online, Zhvillimi i Sistemeve Software, Mbledhja, Ruajtja dhe Analizimi i te Dhenave me karakter studimor, komercial, legal etj., sherbime Hostimi ne Internet etj.

Gjithashtu, "Alpha Base Company" Sh.p.k kryen te gjitha veprimet e nevojshme tregetare te cilat ndikojne ne permbushjen e aktivitetit kryesor te shoqerise, te lartpermendor, sipas legjislacionit ne fuqi.

Organizimi i aktivitetit tregetar te shoqerise eshte i organizuar ne tre shtylla kryesore:



-Alpha Marketing, qe eshte njesia perjegjese per te gjitha aktivitetet ne lidhje me biznesin dhe marketingun,

-Alpha Manager, qe eshte njesia perjegjese per te gjitha aktivitetet ne Hoteleri- Turizem dhe

- Alpha Tech, qe eshte njesia perjegjese per te gjitha aktivitetet ne Internet dhe Software.

NENI 3
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte e pa-peraktuar.

NENI 4
Selia

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Qendra e Biznesit Metropol, rruga Sami Frasher ne Tirane ne ambjentin me numer 7/467-N14, ZK.8380 vol.29 faqe 205.

Adresa e fakes se internetit te shoqerise eshte: www.alphabase.al

Perpos selise se saj, shoqeria ushtron aktivitetin e saj edhe ne qytetin e Bilishtit dhe Korces.

Shoqeria ka te drejte hapjen e filialeve te saj ne te gjitha territorret e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj.


KREU II

NENI 5
Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100,000 Leke i ndare ne 2 (dy) kuota. Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapitalin themeltar te shoqerise. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

1. Ortaku themelues **Marin Kutrolli**: Zoterues i nje kuote me vlore te per gjitheshme 80,000 Leke qe perben 80% te kapitalit themeltar te shoqerise.

2. Ortaku themelues **Olivia Cholakova**: Zoterues i nje kuote me vlore te per gjitheshme 20,000 Leke qe perben 20% te kapitalit themeltar te shoqerise.



NENI 6
Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit

Proceduar per zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit te shoqerise jane si vijojne:

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 7
Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

NENI 8
Organi Vendimmarres



Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.


Administratori i shoqërisë nuk mund të veproje si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9 **Marrja e Vendimeve**

Ne kuader te veprimtarise vendimmarrese te Shoqerise, e cila eshte Asambleja e Ortakeve, votimi organizohet si vijon:

- 10 aksione (pjese) perfaqesojne një vote ne mbledhjet e Asamblese se Ortakeve.
- Ne total jane 1,000 kuota (pjese) te perkthyera ne 100 vota ne Asamble.



- Cfaredolloj votimi apo proces vendimmarres ne "Alpha Base Company" Sh.p.k behet sipas skemes se mesiperme te votimit.
- Per shumicen e ceshtjeve, pervec atyre te specifikuara ne nenin perkates, shumica e thjeshte (50%+1 te votave) mbizoteron.

Asambleja e përgjithshme vendos me 50% +1 te votave te zoteruesve te kapitalit, ku votat jane ne perputhje me kontributin ne kapitalin themeltar të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpérndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;


Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 10
Perjashtimi nga e drejta e votes

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



NENI 11

Administrimi

- Administratori i Shoqerise "Alpha Base Company" Sh.p.k eshte Marin Kutrolli, , i biri i Fatmir-it, lindur me 09.05.1996 ne Korce dhe banues ne Tirane, madhor dhe me aftesi te plete per te vepruar, me mjet identifikimi me numer BB4195016.

Afati i emerimit eshte per nje periudhe 5 vjecare, e cila fillon sot, me 9.09.2019 dhe mbaron me 8.09.2024. Ky emertim behet me te drejte ri-perteritje .

Specimen-i i Nenshkrimit te Administratorit:




NENI 12

Kompetencat e Administratoreve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- kujdesen përmajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- pëргatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmirësuese, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmirësuar;
- raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:
-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.



-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 13
Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë regjistrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;


b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të



rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit


Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

Viti Financiar – Ekspertet

NENI 14
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimi, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.



NENI 15
Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

NENI 16
Konfidencialiteti

Ortaket, si dhe personat e tjere te pranuar ne shoqeri, bien dakord qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe do te disponoje shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe, si dhe planet ose qellimet qe shoqeria ka per te ardhmen e saj.


Njekohesht, te gjitha te dhenat dhe informacionet e klienteve, te cilat perpunohen ose ruhen per qellimet e Shoqerise, jane rreptesish te ndaluara t'I ekspozohen paleve te treta, pervecese me pelqimin dhe konsensusin e plote te klientit apo me urdher gjykate.

NENI 17
Punesimi

Punesimi i personave apo organizatave per qellime te ndryshme te percaktuara ne Statutin e Shoqerise, behet sipas Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise. Punesimi eshte nje vendimmarrje e cila i takon vetem Asamblese se Ortakeve dhe arrihet me votim (shumice e thjeshte).

KREU V

Prishja- Riorganizimi i Shoqerise



NENI 18

Prishja dhe Likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe sheruar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 19

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 20
Baza Ligjore



Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

NENI 21
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKET

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

* "Alpha Base Company" Sh.p.k*

Marin Kutrolli


Marin Kutrolli

(nenshkrimi)



Olivia Ivanova Cholakova

(nenshkrimi)



Olivia Ivanova Cholakova